



PK. SH.A.
Posta e Kosovës SH.A.
Post of Kosovo J.S.C.
Pošte Kosova D.O.

Nr./No./№r.

01-424-1/25

Data/Date/Datum

05-03-2025

PRISTINE-PRISTINA-PRISTINA

Në bazë të nenit 21 të Ligjit bazik nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, lidhur me nenin 13 të Ligjit nr.04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit bazik për Ndërmarrjet Publike, nenit 7.1 të Rregullores nr.01-1974/17 të datës 27.07.2017 dhe nenit 3 të Rregullores nr.01-394-1/25 të datës 28.02.2025 për Ndryshimi/Plotësimi të Rregullores nr.01-1974/17 të datës 27.07.2017 për Sistematizimin e Vendeve të Punës në Nivel Qendror, vendimit nr.05/25 të datës 05.03.2025, Komisioni i Auditimit i NPQ "Posta e Kosovës" Sh.A. shpallë këtë:

K O N K U R S

Pozita e punës: Zyrtar/e për Auditim të Brendshme

Kohëzgjatja e kontratës: 3 vite

Orari i punës: I plotë

Paga: Grada 16

Mbikëqyrës: Komisioni i Auditimit

Përshkrimi: Posta e Kosovës Sh.A. është duke bërë përpjekje për të zhvilluar biznesin sipas përvojave më moderne të shërbimeve postare dhe komerciale, për t'i arritur standardet ndërkombëtare në ofrimin e shërbimeve postare dhe komerciale. Në këtë aspekt, PK Sh.A. ofron mundësi të barabartë punësimi të profesionistëve që synojnë të jenë pjesë e zhvillimit të biznesit dhe kompetencave të Korporatës, në përputhje me metodat dhe praktikat moderne.

Detyrat dhe përgjegjësitë e Zyrtar/e për Auditim të Brendshme janë të përcaktuara në ligjet në fuqi, aktet e brendshme të ndërmarrjes, Kodin e Etikës dhe Qeverisjes Korporative dhe në Rregulloren për Sistematizimin e Vendeve të Punës.

Detyrat dhe përgjegjësitë e punës:

- Në mënyrë të pavarur menaxhon me ekipin dhe punën e caktuar të auditimit;
- Bën rishqyrtimin e proceseve vendimtare të biznesit, duke vlerësuar efikasitetin e kontrollimeve të brendshme dhe duke identifikuar mundësitë e përmirësimit të mundshëm të procesit;
- Vlerëson rrezikun e proceseve kryesore të biznesit që rezultojnë me përgatitjen e planeve dhe programeve specifike të auditimit;
- Identifikon dobësitë e kontrollimit të brendshëm dhe mundësitë për përmirësim;
- Krijon skema të proceseve të rëndësishme financiare, të biznesit dhe operative me qëllim që të rekomandojë mundësitë për përmirësim;
- Përgatit raporte të qarta dhe koncize të auditimit;
- Rishqyrton dhe dokumenton rezultatet e punës së auditimit të kryer nga stafi i Auditimit;
- Siguron dokumentimin e letrave të punës sipas metodologjisë së aprovuar;
- Prezanton tek udhëheqja e lartë konkluzione dhe rekomandime të auditimit;
- Përcjell deri në fund rekomandimet e auditimit;
- Kryen edhe detyra të tjera që lidhen me natyrën e punës së tij/saj, por që nuk bien në kundërshtim me rregullat dhe ligjet në fuqi.

BD



Kualifikimi dhe përvoja e nevojshme:

- Diplomë universitare: fakulteti ekonomik;
- Të jetë person ekspert i certifikuar në kontabilitet;
- Certifikata si auditor në ndonjë institucion të njohur për kontabilitet/auditim (SKAAC, ACCA, CIA, etj) është përparësi;
- 5 vite përvojë të rëndësishme progresive në një firmë/kompani të kontabilitetit;
- Përvojë pune mbi 3 vite në fushën e auditimit të brendshëm. Të jetë ekspert në kontabilitet dhe preferohet përvojë e auditimit;
- Njohuri dhe përvoja lidhur me SNRF si dhe SNA;
- Aftësi të dëshmuara të udhëheqjes, me zotësinë që në mënyrë efektive të punojë nëpër të gjitha nivelet dhe funksionet brenda biznesit;
- Aftësi të forta ndër-personale, me zotësinë që t'u ndihmojë grupeve të ndryshme në drejtim të efikasitetit operativ;
- Njohuri/përvojë gjithëpërfshirëse në menaxhim të projektit, si dhe aftësi të forta në zgjidhje të problemit, analitike, dhe organizative;
- Aftësi të forta në komunikim gojor dhe me shkrim dhe aftësi të dëshmuara prezantimi;
- Proaktiv dhe i përcaktuar në rezultate/metrikë;
- Aftësi për të ndërtuar, trajnuar dhe zhvilluar ekipin;
- E preferuar njohja e gjuhës angleze.

Dokumentacioni i kërkuar:

Kandidati, duhet t'i dorëzoj këto dokumente në formë të skanuar në e-mail:

- Aplikacioni për punësim (shkarkohet nga web-faqja e PK-së <https://postakosoves.com/publikime/mundesipunesimi/>);
- Deklaratën nën betim (e cila shkarkohet nga web -faqja e PK-së <https://postakosoves.com/ep-content/uploads/2021/09/Deklarata-ne%CC%88n-betim.-pdf.pdf>)
- CV – Biografia;
- Letrën motivuese ku theksohet interesimi për pozitën.
- Diploma mbi shkollimi në kopje,(diploma e fituar jashtë Republikës Kosovës duhet të jetë e nostrifikuar sipas Ligjit);
- Certifikata përkatëse si ekspert i Certifikuar në Kontabilitet.
- Dëshmi mbi përvojën e punës;
- Pasqyra e trustit pensional për dëshmi të përvojës së punës
- Kopja e letërnjoftimit apo pasaportës valide;
- Certifikatën mbi dënimin penal nga Gjykata kompetente që kandidati nuk është dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprës penale (certifikata jo më e vjetër se 6 muaj).

Vërejtje: Kandidati duhet të jetë i/e lirë nga çdo konflikt interesi siç përcaktohet me Ligjin për Konfliktin e Interesit.

Përveç kërkesave të lartcekura, kandidatët duhet të jenë persona me integritet të njohur të cilët (i) i plotësojnë kushtet e kualifikimit sipas nenit 17.1, (ii) i plotësojnë kriteret e pavarësisë sipas nenit



17.2, pikat (d), (f), (j), (k) dhe (l) (iii) nuk janë, ose në çfarëdo kohe gjatë periudhës tridhjetë e gjashtë (36) muajsh para datës së aplikimit nuk kanë qenë Drejtorë të Bordit të kompanisë gjegjëse dhe (iv) kanë përvojën e nevojshme profesionale dhe shkollimin e kërkuar për pozitën në fjalë.

-Çdo përgënjeshtim i materialit, qoftë i qëllimshëm ose nga neglizhenca ose ndryshim materiali nga informatat e dhëna në deklaratën e sipër cekur do të rezultojë në skualifikimin e menjëhershëm.

Informata të përgjithshme:

- Të drejtë aplikimi për këtë konkurs kanë të gjitha qytetarët pa dallim.
- Ndërmarrja ofron mundësi të barabarta, inkurajon dhe promovon angazhimin e punëtorëve, pjesëtarë të të gjitha komuniteteve dhe të gjinive të ndryshme.
- Kandidatet me dokumentacion te mangët, të paplotesuar dhe jo adekuat do te refuzohen.

Mënyra e Aplikimit:

Aplikimi mund të bëhet vetëm përmes e-mailit : hr.konkursi@postakosoves.com duke cituar në "subject" titullin e pozitës që aplikon.

Konkursi është i hapur nga data **06.03.2025** dhe përfundon më datë **20.03.2025** në ora 24:00.

Kryesues i Komisionit të Auditimit

